



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË DSHB PËR PERIUDHËN PRILL –
QERSHOR TË VITIT 2025**

Departamenti shëndetësor i burgjeve, bazuar në planin e punës për vitin 2025, buxhetin e aprovuar, stafin që posedon, përpjekjet për zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimit, dhe çështjeve të tjera të planit të punës, nevojave shëndetësore të burgosurve dhe aktivitete të tjera të rëndësisë së veçantë, në dobi të avancimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje për periudhën e tremujorit të dytë (Prill – Qershor 2025 ka funksionuar dhe ka zhvilluar aktivitetet e paraqitura në këtë raport..

Aktivitetet e kryera janë edhe si rrjedhojë e shëndetësore epidemiologjike dhe indikatorëve të paraqitur jashtë planit.

Raport përmbledhës për tremujorin e dytë të vitit 2025 për DShB

Abstrakt: Gjatë periudhës Prill - Qershor të vitit 2025, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve DShB ka funksionuar në njëmbëdhjetë (11) Njësi Shëndetësore të Burgjeve (NjShB) me shërbim 24 orësh, me 140 të punësuar dhe 24 konsultant të kontraktuar.

Gjendja shëndetësore e të burgosurve ka qenë stabile dhe nuk ka pasur ndonjë sëmundje ngjitëse. Rastet vështirë të menaxhueshme janë trajtuar përmes komisioneve multidisiplinare. Ka pasur tri (3) tentim vetëvrasjeje të cilat janë parandaluar me kohë.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsejtë 1,147 të burgosur të rinj, janë realizuar 17,400 shërbime shëndetësore. Janë realizuar 4,276 vizita sistematike, 2,163 intervista psikologjike, 273 analiza laboratorike. Numri i përdoruesve të drogave gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të ketë nivel të lartë 11.16% (128 raste të reja gjatë kësaj periudhe). Ka vazhduar trajtimi me Metadon i përdoruesve të drogave të burgosur sipas indikacioneve.

Furnizimi me material shpenzues, mjete të punës dhe barëra ka qenë i rregullt dhe nuk ka mungesë të barërave gjatë kësaj periudhe. Tani jemi pa kontratë dhe jemi në proces të gjetjes së zgjidhjes për furnizime nga MSh dhe pjesa tjetër në proces të tenderimit. Edhe shërbimet e tjera kanë përfunduar sipas planit të punës.

NjShB kanë qenë të furnizuara mjaftueshëm me të gjithë artikujt e nevojshëm të punës.

Buxheti është duke u menaxhuar konform planit. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është duke u shpenzuar me kursime dhe sipas planit përderisa kategoria e kapitaleve, është proceduar gjatë kësaj periudhe dhe pritet të përfundohet sipas planit.

Kushtet higjienike sanitare kanë qenë të mira dhe nën mbikëqyrje të vazhdueshme përmes masave të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë edhe DDD-në e të gjitha hapësirave të burgjeve, sipas planit të punës, kontratës dhe buxhetit.

Janë ndërmarrë masat përkatëse për menaxhimin e kushteve të të nxehtit të periudhës verore, furnizimit me ujë, ajrosje dhe ushqim.

Nën mbështetjen e Këshillit të Evropës, ka vazhduar zbatimi i projektit “Përmirësimin e trajtimit për personat e privuar nga liria” me përgatitjen e PSV-ve, zbatimin e tyre në vend të punës dhe trajnimin e trajnerëve.

Me Institucionin e Avokatit të Popullit, përkatësisht Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e Torturës ka vazhduar bashkëpunimi i ndërsjellët dhe kemi dhënë përgjigje për rastet e caktuara me kërkesë të tyre. Gjatë kësaj periudhe për DShB nuk ka pasur asnjë rekomandim për zbatim nga ky mekanizëm.

Gjatë muajit Qershor është mbajtur Konferenca e IAP të Ballkanit Perëndimor me temën boshte për shëndetin mendor, ku kemi pasur një prezantim i cili është vlerësuar lartë dhe mënyra e funksionimit të DShB është kërkuar të merret shembull nga këto vende. Ky delegacion ditën e dytë ka vizituar edhe IKShTPNV në Dubravë dhe kanë shprehur admirimin e tyre për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të këtij institucioni, të veçanet në rajon.

Së bashku me ShKK kemi pasur takime të rregullta dhe koordinime në menaxhimin e rasteve dhe situatave të caktuara në vazhdimësi.

Gjatë kësaj periudhe disa të punësuar kanë lënë punën dhe tani jemi në proces të zëvendësimit të tyre. Qëndrueshmëria e stafit ka filluar të bëhet çështje e cila kërkon më shumë angazhim të gjithmbarshëm.

Kemi punuar në kundërshtimin e vendimeve të gjykatës për pagat jubilarë dhe të trembëdhjeta si pasojë e vendimeve individuale. Ne ende mendojmë se kjo çështja duhet të rregullohet me një proces gjithëpërfshirës në nivel vendi.

Janë shqyrtuar të gjitha ankesat e të burgosurve në çfarëdo forme, përfshirë kutitë e ankesave apo formave të tjera të ankimit dhe janë dhënë përgjigjet përkatëse.

Në paraqitje tabelare të të dhënave të shërbimeve shëndetësore në këtë tremujor mund të gjeni edhe krahasimet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Te dhenat mbi disa indikatorë të DShB, Prill -Qershor 2025		Muajt			Totali, tremujori i dytë 2025	Totali, tremujori i dytë 2024
Nr	Indikatori	Prill	Maj	Qershor		
1	Te burgosur te pranuar	393	442	312	1147	1172
2	Te burgosur te liruar	334	352	328	1014	886
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	355	442	312	1109	1172
4	Konsulta mjekesore	2528	2503	2312	7343	6275
5	Konsulta psikiatrike	755	652	556	1963	1498
6	Konsulta psikologjike	756	826	581	2163	1437
7	Sherbime dentare	260	267	217	744	713
8	Sherbime te tjera mjekesore	1347	1660	1563	4570	5097
9	Totali i konsultimeve shendetesore	5841	6155	5404	17400	15689
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	8	10	3	21	27
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	13	10	12	35	45
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	234	254	251	739	652
13	Dergimet jashte IK per intervenime	18	20	15	53	62
14	Transferet shendetesore	5	8	13	26	17
15	Rastet me TBC	0	0	0	0	1
16	Rastet me HEPATIT B	0	0	0	0	2
17	Rastet me HEPATIT C	0	3	1	4	4
18	Rastet HIV pozitiv	0	1	0	1	0
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	176	230	141	547	350
20	Analizat e gjakut sipas planit	44	112	13	169	222
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	28	53	24	105	135
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	0	0	0	0
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1343	1375	1522	4240	4363
24	Kontrollet stomatologjike sistematike	16	13	31	60	78
25	Kontrollet gjinekologjike sistematike	6	5	5	16	14
26	Mamografi	0	0	0	0	0
27	PAPA test	0	0	0	0	0
28	RTG Pulmo	33	43	37	113	51
29	Neurotic Syndromes	260	256	261	777	794
30	Psychotic Syndromes	27	33	36	96	95
31	Semundjet kardiovaskulare	47	79	56	182	216
32	Semundjet Respiratore	102	123	101	326	323
33	Semundjet gastrointestinale	113	95	120	328	272
34	Semundjet urogenitale	27	40	35	102	115
35	Semundjet e lekures	73	84	72	229	206
36	SS te transmetueshme	0	1	0	1	12
37	Semundjet e sistemit lokomotor	119	86	104	309	270
38	Semundjet infektive	1	4	3	8	10
39	Vete lendimet	12	10	11	33	52
40	Lendimet trupore	30	28	50	108	111
41	Abuzimet seksuale	0	0	0	0	1
42	Rastet ne greve te urise	6	14	12	32	16
43	Tentim vetevrasjet	1	1	1	3	3
44	Vetmia - Izolimi	25	27	38	90	99
45	Vdekjet ne burg	0	0	0	0	1

Tabela numër 1, përmbledhje tre mujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Bazuar në tabelën numër një, ku janë prezantuar të dhënat epidemiologjike duke i krahasuar tremujorin e dytë të këtij viti dhe atij paraprak, mund të përfundojmë si në vijim:

1. Ecuria e aktiviteteve dhe indikatorëve është pothuajse e njëjtë me një trend linear dhe jo signifkante;
2. Nuk ka shtim të numrit të burgosurve por ka qarkullim më të madh të të burgosurve gjatë vitit 2025 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.
3. Gjatë këtij tremujori, krahasuar me atë të vitit paraprak, ka numër të njëjtë, proporcional me numrin e të burgosurve, përafërsisht të aktiviteteve si ato mjekësore, psikologjike, psikiatrike, dentare dhe total konsultime, me një trend të rritjes së lehtë të numrit të shërbimeve.
4. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me atë të vitit paraprak ka rritje të numrit të shërbimeve, krahasuar sa i takon aplikimit të testeve psikologjike dhe analizave laboratorike, qofshin ato të planifikuara apo sipas indikacioneve.
5. Trendi i sëmundjeve edhe këtë periudhë është i njëjtë me atë paraprake, pa ndonjë ndryshim të theksuar, signifkant.
6. Këtë tremujor, lëndimet trupore dhe indikatorët e tjerë të ngjashëm janë përafërsisht të njëjtë, përfshirë edhe tentim vetëvrasjet , ku kanë qenë vetëm 4 raste dhe nuk ka pasur asnjë vetëvrasje të realizuar.
7. Gjatë këtij tremujori nuk kemi pasur asnjë rast të vdekjes.

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje në tremujorin e dytë të vitit 2025 kanë vazhduar me kryerjen e të gjitha shërbimeve me theks të veçantë në masat e shtuar për detektimin dhe menaxhimin e rasteve me rrezik potencial për vetëvrasje apo vetëlëndim.

Shërbime e shëndetit mendor në burgje, duke përfshirë intervistat e para psikologjike, ekzaminimi i statusit mendor, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psikologjike janë ofruar nga psikologët në format të kombinuar, edhe në zyre dhe në blloqe, pavijone e hapësira të përshtatura.

SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDORË TË OFRUARA NË BURGJE				
Nr	Tremujori i dytë i vitit	Shërbimi	Viti 2025 (3m2)	Viti 2024 (3m2)
1	2025	Konsulta shëndetësore	7343	6275
		Vizita psikiatrike	1963	1498
		Seanca psikologjike	2163	1437

Tabela numër 2. Shërbimet e shëndetit mendor në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2025.

Nuk vërehet ndonjë dallim signifkant në krahasimet në mes të dy periudhave të këtij viti dhe atij paraprak, përpos një rritje të numrit të dukshëm të vizitave të profilit psikologjik dhe psikiatrik edhe në raport me shërbimet në total shëndetësore. Rritja e numrit të këtyre shërbimeve edhe një herë dëshmon për zbatimin e angazhimeve të marra në trajtimin e rasteve me çrregullime mendore dhe jo vetëm, që nga pranimi, identifikimi, përgatitja e punës, plani i punës grupore, puna dhe të tjera të ngjashme në dobi të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të shëndetit mendor në burgje.

Bazuar ne planin e punës dhe qëllimet strategjike të DShB nga stafi i shëndetit mendorë në të gjitha njësitë ka vazhduar vlerësimi intensiv psikologjik për të detektuar rastet e me vështirësi në menaxhimin e gjendjes psikologjike dhe atyre me rrezik për vetëvrasje. Ky vlerësim psikologjik po kryhet në vazhdimësi përmes baterisë së testeve zyrtare të DShB për vlerësim psikologjik dhe inventarëve të tjera klinike sipas përzgjedhjes së psikologëve.

BATERIA ZYRTARE E TESTEVE PSIKOLOGJIKE	NË DSHB
FUSHA E VLERËSIMIT	MJETI MATËS
Vlerësimi fillestarë dhe i përgjithshëm i gjendjes psikologjike	Pasqyra Psikologjike
Vlerësimi i konstrukteve dhe çrregullimeve bazë psikologjike	CORNELL INDEX
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së ankthit	Beck's Anxiety Inventory
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së depresionit	Beck's Depression Inventory

Tabela numër 3. Tabela e mjeteve zyrtare për vlerësim psikologjik në burgjet e Kosovë

Rastet janë vënë në menaxhim të ekipeve multidisciplinare për menaxhimin e personave me rrezik për vetëvrasje në të gjitha burgjet. Sipas kushteve të përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2023/DSHB, janë arkivuar në DShB së bashku me raportet e vazhdueshme të punës së këtyre komisioneve të emëruara me vendim të përbashkët të udhëheqësve të njësive dhe drejtorëve të burgjeve.

Aplikimi i terapisë okupuese me pacientët e vendosur në Institucionin për trajtimin e personave me nevoja të veçanta ka vazhduar përmes Udhëzuesit dhe zbatimit të tij. Gjatë kësaj periudhe janë proceduar pajisjet përkatëse për aplikim të kësaj terapie në një standard më të lartë.

Mbështetja e komisioneve multidisciplinare për deradikalizimin e të burgosurve Edhe përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2025 stafi i shëndetit mendor në burgje ka ofruar mbështetjen e vet profesionale dhe të vazhdueshme për komisionet multidisciplinare për deradikalizimin e të burgosurve – veçanërisht në BSL dhe QK Dubravë. Si dhe trajtimi i kategorive specifike përfshirë edhe atyre që kanë kryer dhunë në familje.

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2025 janë mbuluar nga dhjetë (10) psikolog klinik me orar të plotë të punës, (2) psikolog klinik konsultant, tre (3) psikiatër i rregullt, dy (2) me gjysmë norme dhe shtatë (7) psikiatër konsultant. Psikologët nga njësi të ndryshme janë angazhuar kohë pas kohe në trajnimet të përbashkëta me SHKK në funksion të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve.

Meqë mund të konsiderohet se nga ana e DShB është siguruar tashmë një stabilitet i stafit të shëndetit mendor, avancimi i tyre profesional si dhe kushtet teknike e logjistike për punë. Sfidë e rëndësishme edhe në vitin 2025 mbetet numri i madh i të paraburgosurve me probleme të natyrës psikike për të cilët gjykata ka lëshuar një urdhër për vlerësim apo trajtim të detyrueshëm në IPFK por në mungesë të vendeve në IPFK mbahen nëpër qendrat e paraburgimit duke e mbingarkuar kështu stafin e shëndetësor në përgjithësi dhe stafin e shëndetit mendor në veçanti.

Në funksion të rritjes së numrit të stafit dhe profesionalizmit të tyre, tanimë është stabilizuar edhe përcjellja e disa indikatorëve që në pranim në aspektin e identifikimit ët llojeve të çrregullimeve në pranim në mënyrë që të vazhdohet me trajtimin e tyre me qasje multidisciplinare si në tabelën e më poshtme ku shihet qartë se identifikimi i rasteve ndihmon në mënyrën e planifikimit dhe trajtimit të tyre në vazhdimësi. Qasja multidiciplinare në këtë aspekt është e pa zëvendësueshme ashtu siç janë edhe vet indikatorët.

Në këtë periudhë janë lëshuar 29 raporte me kërkesa të avokatëve, gjykatave apo prokurorisë për mënyrën e trajtimit të personave të mbajtur në burgje.

DShB- Indikatorët specifik të përcjellë gjatë periudhës Prill - Qershor 2024					
Nr	Aktiviteti	Numri i rasteve	Shkalla e potencës		
			1	2	3
1	Rreziku për vetvrasje	11	4	4	3
2	Rrezik për vrasje	3	2	0	1
3	Përdorimi i drogave	167	22	24	121
4	Përdorimi i alkoolit	63	31	0	32
5	Përdorimi i duhanit	679	50	4	625
6	Dhunim sexual	14	4	0	10
7	Dhuna në familje	132	11	13	108
8	Extremizëm fetar	10	0	1	9
9	Tjetër	67	0	0	67

Tabela numër 4, Përcjellja e disa indikatorëve specifik , psikologjik, me qasje multidisciplinare në burgjet e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2025.

Përcjellja e disa indikatorëve tregon se kemi rënie të përqindjes së përdoruesve të duhanit, alkoolit, drogave, ndërsa rritje të numrit të atyre të pranuar me lëndime trupore, raste këto që po procedohen për trajtim më tutje, sipas PSV-ve.

Raportimi i tremujorit të dytë, për vitin 2025, për disa indikatorëve në burgje							Të dhënat për tremujorin e dytë të vitit 2024	
Nr	Lloji i të dhënave	Prill	Maj	Qershor	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	393	442	312	1,147	100.00	1,172	100.00
2	Numri i duhangjinjeve	215	243	178	636	55.45	789	67.32
3	Numri i abuzuesve të alkoolit	9	12	13	34	2.96	49	4.18
4	Numri i abuzuesve të drogave	36	53	39	128	11.16	144	12.29
5	Rastet me Hepatitis B	0	2	0	2	0.17	2	0.17
6	Rastet me Hepatitis C	0	2	2	4	0.35	2	0.17
7	Rastet me lëndime trupore	23	23	31	77	6.71	81	6.91
8	Rastet me TBC	0	0	0	-	-	1	0.09
9	Rastet me Diabet	5	11	8	24	2.09	19	1.62
10	Rastet me SST (AIDS)	0	0	0	-	-	-	-
11	Rastet me Hipertension Arterial	15	23	17	55	4.80	75	6.40

Tabela numër 5, përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik të DShB

Rastet e varura nga drogat, janë trajtuar në vazhdimësi në mënyrë adekuate dhe përmes programit të metadonit në të gjitha NjShB-të pa vazhdimësi dhe me sasi të mjaftueshme të stafit dhe produktit.

Raporti i shpenzimit të Metadonit për tre mujorin e dytë 2025						
Shkurtesat	Përshkrimi	Gjendja paraprake	Prill	Maj	Qershor	Totali
RV	Rastet në Vazhdim	113	45	38	40	123
R	Rastet e Reja	32	7	9	6	22
RP	Rastet e Perseritura	14	6	1	3	10
RL	Rastet e Larguara	16	13	5	13	31
TPz	Totali i Pozitave	159				159
	Totali i Mililitrave të Shpenzuara	20,994.00	7,509.00	7,171.00	6,208.00	42,182.00
	Totali i mililitrave të pranuar	22,300.00	5,000.00	7,000.00	3,000.00	37,300.00

Tabela numër 6, menaxhimi i shpenzimit të Metadonit në DShB;

Sipas tabelës së më poshtme, përkundër asaj që shihet nga zvogëlimi i vogël në përqindje, ende ky numër është i lartë dhe vazhdon të jetë i tillë.

Raportimi i tremujorit të dytë, për vitin 2025, për disa indikatorëve në burgje							Të dhënat për tremujorin e dytë të vitit 2024	
Nr	Lloji i të dhënave	Prill	Maj	Qershor	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i të vizituarve për herë të parë	393	442	312	1,147	100.00	1,223	100.00
4	Numri i abuzuesve të drogave	36	53	39	128	11.16	144	12.29

Tabela numër 7 përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik të DShB

Kemi pasur disa sëmundje ngjitëse, skabies dhe morra të kokës. Gjatë kësaj periudhe natyrisht ka pasur masa të shtuara higjienike në burgje me mjete higjienike të institucioneve.

Kushtet higjienike sanitare kanë qenë në nivel dhe është kryer nga masa e DDD sipas planit dhe masave të parapara. Kontraktimi i DDD për një periudhë tre vjeçare siguron mirëmbajtjen e kushteve higjienike sanitare në burgje si komponentë mjaftë e rëndësishme për institucionet siç janë burgjet dhe ku popullimi i institucionit është 24 orë për tërë vitin. Janë ndërmarrë masat përkatëse për menaxhimin e kushteve të të nxehtit të periudhës verore, furnizimit me ujë, ajrosje dhe ushqim.

Raporti i kontrollës Higjienike në Burgje, Prill - Qershor 2025			Burgjet											Totali	Rezultati Final
Nr	Njësitë	Parametrat specifik që inspektohen	Dubravë	Lipjan 1	Lipjan 2	Lipjan 3	Prizren	Gjilan	Pejë	Mitrovicë	Prishtinë	Smrek	BSL		
1	Ambulanta	Higjiena	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	4.67	52.67	4.79
2		Mbeturinat mjekësore	4.33	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	54.00	4.91
3		Barërat pa afat, kontrolli, evidenca	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	5.00	54.67	4.97
4		Stacionari, miëmbajtja, qarqafët, higjiena...	3.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	4.00	5.00	5.00	4.67	51.33	4.67
5	Depoja e depos	Gjendja e depos	3.00	4.00	4.33	4.00	4.67	4.00	3.33	4.00	5.00	4.33	4.00	44.67	4.06
6		Temperatura	4.00	5.00	3.67	5.00	5.00	4.00	4.67	5.00	5.00	4.33	5.00	50.67	4.61
7		Skadencia	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	4.00	5.00	5.00	4.67	53.33	4.85
8		Higjiena	4.00	4.33	4.33	4.67	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	4.00	3.67	46.00	4.18
9	Kuzhina	Higjiena e hapësirave	3.00	3.67	3.67	3.67	5.00	4.00	4.00	4.00	5.00	5.00	3.33	44.33	4.03
10		Higjiena e pajisjeve	4.00	4.00	4.00	4.00	4.67	4.00	4.00	4.00	5.00	5.00	4.33	47.00	4.27
11		Higjiena e përpunimit të ushqimit	4.00	4.00	4.33	4.00	5.00	5.00	3.67	4.00	5.00	5.00	3.67	47.67	4.33
12		Kontrolli i cilësise (kualiteti dhe higjiena)	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	4.67	4.00	5.00	4.00	4.33	47.00	4.27
13	Uji i pijes	Kontrolli i sasië (kalorive)	4.00	4.67	4.00	4.33	5.00	4.00	4.00	4.00	5.00	3.67	3.67	46.33	4.21
14		Marrja dhe ruajtja e mostres (72 orë)	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	5.00	54.67	4.97
15		Rrjedhshmëria	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	4.00	5.00	4.00	4.33	51.00	4.64
16		Cilësia	4.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	4.33	4.00	5.00	4.67	3.67	47.67	4.33
17	Stafi	Uniformat	4.00	4.00	4.00	4.33	4.00	4.00	3.67	4.00	5.00	2.00	3.67	42.67	3.88
18		Librezat Sanitare	5.00	4.67	5.00	4.33	5.00	4.00	4.33	5.00	5.00	4.33	4.67	51.33	4.67
19	Dhomat e banimit	Kushtet higjienike sanitare	4.00	3.67	4.00	4.00	4.00	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	43.67	3.97
20		Ndërrimi i qarqafëve 2 herë në muaj	3.00	4.67	4.00	4.33	4.00	5.00	3.67	4.00	5.00	4.00	4.33	46.00	4.18
21		Ndërrimi i batanijeve çdo 3 muaj	3.00	4.67	5.00	4.67	3.67	5.00	3.67	4.00	5.00	4.00	4.00	46.67	4.24
22		Larja e nërresave çdo javë	3.00	4.67	5.00	4.67	4.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	4.00	50.00	4.55
23		Mjetet higjienike personale	3.00	3.33	3.67	4.00	4.00	3.00	3.33	4.00	5.00	4.00	4.67	42.00	3.82
24		Mjete higjienike të dhomës	3.00	3.33	4.67	3.67	4.00	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	42.67	3.88
25	Nyjet sanitare	Hiigjiena	3.00	4.00	3.67	4.33	3.67	3.00	4.00	5.00	5.00	4.00	4.00	43.67	3.97
26		Uji i rrjedhshëm	4.00	5.00	4.00	5.00	4.33	5.00	4.00	5.00	5.00	4.00	4.67	50.00	4.55
27		Mjetet higjienike	3.00	3.67	4.00	4.00	3.67	3.00	3.67	4.00	5.00	4.00	4.33	42.33	3.85
28		Higjiena	4.00	3.33	4.00	4.00	4.00	3.00	3.33	3.33	5.00	4.00	4.00	42.00	3.82
29	Bnjot	Mjetet higjienike	3.00	3.33	5.67	4.00	4.00	3.00	3.67	4.00	5.00	4.00	4.00	43.67	3.97
30		Uji i rrjedhshëm	3.00	5.00	5.00	5.00	4.33	5.00	3.67	4.00	5.00	4.00	5.33	49.33	4.48
31	DDD	Frekuenca e larjes sipas specifikave	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	46.00	4.18
32		Dezinfektimi i ditor	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	3.00	4.00	5.00	5.00	3.00	5.00	47.00	4.27
33		DDD e rregullt periodike, çdo 3 muaj	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.33	5.00	5.00	5.00	5.00	54.33	4.94
34			-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
35	Tjera		-	-	-	-	-	-	0.67	-	-	-	-	0.67	0.06
36			-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali, mesatarja për institucione			3.74	4.42	4.48	4.52	4.42	4.18	4.11	4.28	5.00	4.28	4.32	47.77	4.34
Mesatarja e vlerësimit të kushteve higjienike sanitare në burgje (vlerat matëse nga 0-5)															

Mesatarja e vlerësimit të kushteve higjienike sanitare në burgje, (vlerat matëse nga 0 - 5)

Tabela numër 6, gjendja higjienike sanitare sipas indikatorëve dhe NjShB-ve;

Barërat: Furnizimet me material mjekësor, administrativë, të higjienës dhe mjete mbrojtëse ka qenë i qëndrueshëm dhe sipas planit.

Gjate këtij tremujori, është kryer monitorimit i punës në disa Njësi Shëndetësore të Burgjeve. Në ndërkohë është përcjellë puna e tyre me raportime të rregullta mujore si dhe evidentimi i shpenzimeve ditore nga Kryeinfermierët përkatësisht përgjegjësit e barnatoreve doracake të këtyre njësive dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Nga të gjitha Burgjet iu është kërkuar të bëhen kërkesat për këtë periudhë për furnizim me barna, gjë që ka përfunduar në këtë gjashtëmujor. Porositja e barnave është bërë sipas kërkesës së qendrave dhe po ashtu është bërë edhe distribuimi nga depoja qendrore në QK Lipjan nëpër të gjitha qendrat tjera. Procesi ka shkuar në rregull.

Është bërë regjistrimi i të gjitha barnave në SMSF dhe ka filluar regjistrimet e hyrjeve dhe daljeve të terapisë sipas rekomandimeve të DSISH.

Janë të përfunduara të gjitha procedurat e prokurimit sipas planifikimit të bërë dhe jemi në pritje të përgjigjes për procedurat më tutjeshme.

Menaxhimi i kontratave: Jemi në komunikime të vazhdueshme me OE sipas procedurave të menaxhimit të kontratave.

Të gjitha kontrata janë të regjistruara në e-prokurimi dhe menaxhimi i tyre vazhdon sipas sistemit. Për momentin DSHB, për shërbime Farmaceutike, gjithsej ka të lidhura katër (4) kontrata me operatorë ekonomik.

Furnizimet dhe Shpenzimet: Aktualisht kontrata ka përfunduar si në aspektin kohor ashtu edhe në aspektin e sasisë së paraparë. Me qëllim të mbulimit të nevojave esenciale dhe mos ndërprerjes së terapisë për paciente, kemi shfrytëzuar mundësinë e paraparë me kontratë për furnizim shtesë deri 30% sipas dispozitave në fuqi. Ky furnizim është bërë në përputhje me procedurat dhe duke pasur parasysh gjendjen reale të stokut dhe kërkesat e njësive shëndetësore.. Pavarësisht sfidave dhe procedurave të prokurimit, është bërë e mundur të mos krijohen mungesa kritike në barna.

Në mungesë të kontratës së rregullt, me qëllim të mbulimit të nevojave urgjente, është bërë kërkesë për furnizim me barna nga departamenti i farmacisë. Si rezultat i kësaj kërkesë janë siguruar sasi të minimale të barnave për të garantuar vazhdimësinë e trajtimit të pacientëve.

Shpenzimet për barna gjate kësaj periudhe janë realizuar në përputhje me buxhetin e ndare dhe të planifikuar. Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat për sasinë e barnave të shpenzuar e llogaritur në vlerë monetare.

Duke u bazuar në raportet e NjShB-ve lidhur me shpenzimet e barnave, vlera e shpenzimeve të barërave, në total, për të gjitha burgjet për tremujorin e dytë, është: **27,640.25 €**.

(Nuk janë të llogaritura shpenzimet e materialit shpenzues mjekësor, produktet stomatologjike, pajisjet e imëta mjekësore dhe laboratorit).

Nr.	Njësia Shëndetësore e Burgjeve	Shuma gjashtëmujore të parë e shpenzimit (€)
1.	NjShB - Dubravë	9,790.85
2.	NjShB - BSL	4,031.15
3.	NjShB - Smrekonicë	1,240.78
4.	NjShB - QKML	352.21
5.	NjShB - Prishtinë	3,881.21
6.	NjShB - Prizren	1,195.76

7.	NjShB - Gjilan	3,081.21
8.	NjShB - QKFL	871.05
9.	NjShB - Pejë	795.12
10.	NjShB - Mitrovicë	966.63
11.	NjShB - QEK	112.62
12.	IShTPNV Dubravë	1,388.75

Tabela numër 10 Shpenzimet sipas NjShB-ve me barëra për këtë gjashtë mujor;

Nga kodi buxhetor 13,630 i ndarë për shërbime farmaceutike të parapara janë 90,000.00, ku nga këto janë shpenzuar 82,306.56 në barna.

Sfidat dhe rekomandimet: Proceset e prokurimit janë në zhvillim e sipër, çka ka krijuar mungesë në furnizim dhe nevojën për zgjidhje alternative të furnizimit.

Kërkohej finalizimi i kontratave për të garantuar stabilitet në furnizim dhe shmangie të mungesave të barnave.

Rekomandohet që në periudhën në vijim të intensifikohet përpjekje për përfundimin e procedurave të prokurimit dhe të sigurohet një kontratë e qëndrueshme për furnizim me barëra.

Asgjësimi i barnave: Sipas procedurave dhe planifikimit paraprak për menaxhimin e barnave si dhe ne përputhje me standardet e ruajtjes së sigurisë dhe cilësisë së produkteve farmaceutike, ju njoftoj se në këtë gjashtë mujor kemi filluar me procesin e identifikimit dhe evidentimit të barërave të cilat do të iu nënshtrohen procedurave të asgjësimit. Procesi është në fazën përfundimtare.

Ka funksionuar mirë Institucioni për kujdesin e personave me Nevoja të veçanta në burgun e Dubravës me kapacitet prej 81 vendeve të parapara për persona me nevoja të veçanta në lëvizje dhe moshë, ata me sëmundje kronike të vazhdueshme e që kërkojnë trajtim mjekësor permanent, personat me çrregullime psikiatrike të dënuar dhe personat përdorues të drogave.

Ka vazhduar zbatuari Projekti me Këshillin e Evropës. Këtë periudhë kemi qenë të angazhuar në rishikimin e PSV-ve nga ekspertët e KE dhe staf. Si rezultat është përpunuar drafti final i cili është në përfundim e sipër.

Gjatë kësaj periudhe, sa i përket projektit me Këshillin e Evropës, "Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria", është mbajtur trajnimi i radhës më datat 12 dhe 14 maj 2025, me pjesëmarrjen e 12 profesionistëve shëndetësorë dhe me datat 24 dhe 25 qershor 2025, me pjesëmarrjen e 6 profesionistëve shëndetësorë.

Buxheti është planifikuar sipas nevojave dhe është bërë plani i rrjedhës së parasë i cili është duke u zbatuar. Gjatë kësaj periudhe kanë përfunduar disa aktivitete mjaftë të rëndësishme të prokurimit, të tjera janë në procedurë. Gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 806,165.44 € në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, 219,858.75 € në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, 1,209.56€ në kategorinë e komunalive dhe 4,2998.00€ në kategorinë e kapitaleve.

Buxheti i mbulon nevojat bazike sipas planit dhe projeksionit për rritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore për të burgosurit. Ende është brengë çështja e procedurave të prokurimit dhe respektimit të kontratave nga OE si dhe buxheti jo adekuat sipas planit, shërbimeve dhe specifikave në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ku mungojnë së paku 120,000.00€.

Shpenzimi i buxhetit të DShB, kodi 726, 6m1, për Vitin 2025, sipas kategorive					
Nr	Kategoria	Buxheti i ndarë për vitin 2024	Shpenzuar deri me 11.12.2024	Perqindja e shpenzimit	Vërejtje
1	Kodi 726; DShB, Buxheti Total	2,306,403.00	1,071,713.31	46.47	Total buxheti i realizuar
2	NUMRI I STAFIT	140	140	100	
2	RROGA DHE PAGA	1,510,903.00	807,647.00	53.45	Është tejkaluar shuma e paraparë si pasojë e mos paraqitjes së shtesave për ndrrime të natës dhe kujdestari.
3	MALLRA DHE SHËRBIME	740,000.00	219,858.75	29.71	Nuk është realizuar sipas planit si pasojë e disa vonesave ne proceduar të prokurimit, të tjerat janë në proces.
4	SHPENZIME KOMUNALE	5,500.00	1,209.56	21.99	Ka pasur kursime.
5	PASURITË JO FINANCIARE - KAPITALET	50,000.00	42,998.00	86.00	Është përfunduar projekti, kemi tepriçë shumën prej 7,000.00E, do të zhvillojmë procedurë të re.

Tabela numër 11, Pasqyrimi i shpenzimit të buxhetit deri me 30 Qershor 2025;

Janë zbatuar aktivitetet e mirëmbajtjes së pajisjeve sipas kontratave dhe kërkesave. Të gjitha pajisjet janë funksionale përfshirë ato radiologjike, laboratorike, stomatologjike, fizioterapeutike etj.

Lidhur me funksionimin Sistemit Informativ Shëndetësor janë zhvilluar këto aktivitete:

Më datë 15.05.2025 është organizuar dhe mbajtur trajnimi për modulën e metadonit, në telemjekësi, me pjesëmarrjen e 17 profesionistëve shëndetësorë.

Më datë 18.06.2025 kemi zhvilluar një takim me kompaninë DataPrognnet, DSISh dhe zyrtarët e DF në MSh për të diskutuar rreth problematikave që po hasim në lidhje me punën në SMSF, për artikujt që kërkohen dhe aprovohen nga DF për DShB, si dhe për kërkesat për Metadon. Në këtë takim, është kërkuar edhe një takim shtesë në zyrat e DShB për rishikimin e sistemit, veçanërisht për njësitë shëndetësore të burgjeve dhe DShB.

Ndërkohë, kërkesat dhe furnizimi me Metadon po zhvillohen pa probleme përmes SMSF. Megjithatë, menaxhimi i shpenzimit të Metadonit po has në disa vështirësi në disa njësi, për shkak të një problemi në hyrjen e të dhënave nga Departamenti i Farmaceutik (DF) në MSh. Këtë çështje e kemi paraqitur tek DSISH dhe DF për gjetjen e një zgjidhjeje.

Sa i përket sistemit të menaxhimit të dosjeve mjekësore BHIS, janë dërguar referenca të detajuara sipas specifikës për dosjet mjekësore në burgje, por ende nuk ka kontratë aktive me MSh.

Në sistemin digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse (SMSN), është bërë raportimi i rasteve në njësitë ku ka pasur raste.

Kemi bërë kërkesa për Inspektime nga inspektoratet relevante në fillim vit, përfshirë edhe Auditimin e brendshëm. Kemi pasur inspektime sporadike me kërkesë nga këto njësi.

Gjate këtij tre mujori, është kryer monitorimit i punës tek disa NJShB. Në ndërkohë është përcjellë puna e tyre me raportime të rregullta mujore si dhe evidentimi i shpenzimeve ditore nga kryeinfermierët përkatësisht përgjegjësit e barnatoreve doracake të këtyre njësive dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Në kuadër të ShSKUK, përmes koordinimit nga infermierja koordinatore janë kryer këto shërbime për të burgosur: gjithsejtë janë kryer 308 shërbime të asistuar, prej tyre; 15 MRI, 12 CT, 2 EEG, 9 Holter EKG, 9 Ehokardiografi, 7 analiza histopatologjike dhe shërbime të tjera të nevojshme.

Në kuadër të SP të Pejës, përmes infermieres koordinatore, në këtë periudhë janë kryer këto shërbime: 252 shërbime, 57 konsulta specialistike, 17 intervenime specialistike dhe 10 hospitalizime me intervenime. Në këtë Spital janë kryer edhe një numër i madh i shërbimeve forenzike me urdhëresë nga gjykatat kompetente.

Qëndrueshmëria e stafit ka filluar të bëhet sfidë edhe më e madhe si pasojë e disa lbraktisjeve të vendit të punës së stafit shëndetësor, përfshirë infermier dhe mjek. Kërkesat për të marrë vërtetime si dhe pakënaqësia e mos ndarjes së specializimeve do të ndikojnë drejtë për së drejti në tri institucione, Gërdovc për mbulimin e shërbimit me mjek 24 orë, në Dubravë në IKShTPNV me mungesë mjeku për këtë njësi si dhe në NjShB në Pejë.

Është bërë edhe përfundimi i vizitës sistematike të stafit dhe është marrë aprovimi për vitin 2025. Jemi në përfundim të fazës së vaksinimit të stafit të ShKK dhe DShB me HBV Vaksinë.

Në vazhdimësi jemi duke zhvilluar aktivitete lidhur me menaxhimin e gjendjes shëndetësore të burgosurve dhe ndërmarrjen e aktiviteteve përkatëse, bazuar në planin e punës dhe PSV-të për trajtimin shëndetësor të burgosurve.

Bashkëpunimi me ShKK është shumë i mirë dhe po e lehtëson funksionimin dhe koordinimin e punëve të përbashkëta në dobi të shëndetit të pacientëve dhe efikasitetit në punë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet gjendja e popullatës me disa indikatorë të veçantë të cilët detyrojnë edhe shërbime specifike për këto kategori:

Të dhënat nga DShB lidhur me disa indikatorë me gjendjen aktuale, Qershor 2025					
Nr	Institucioni	Indikator			
		Mbi 65 vjet	Me nevojë të veçanta	Sëmundje kronike	Çrregullime mendore dhe të personalitetit dhe me terapi psikiatrike
1	NjShB në Dubravë	15	3	105	176
2	NjShB në Gërdovc	12	0	60	25
3	NjShB në Smrekovicë	8	0	7	2
4	NjShB në Prishtinë	6	0	23	60
5	NjShB në Gjiilan	1	0	22	70
6	NjShB në Prizren	2	0	14	17
7	NjShB në Mitrovicë	3	0	15	18
8	NjShB në Pejë	1	0	8	14
9	NjShB në QK të Miturve	0	0	0	3
10	NjShB në QK të Femrave	1	1	4	15
11	NjShB në QK të miturve të avancuar	0	0	1	0
12	Perqindja				
13	Totali	49	4	259	400

Tabela numër 12, indikatorët specifik të gjendjes së popullatës së burgosur;

Gjatë muajit Qershor është mbajtur Konferenca e IAP të Ballkanit Perëndimor me temën boshte për shëndetin mendor, ku kemi pasur një prezantim i cili është vlerësuar lartë dhe mënyra e funksionimit të DShB është kërkuar të merret shembull nga këto vende. Ky delegacion ditën e dytë ka vizituar edhe IKShTPNV në Dubravë dhe kanë shprehur admirimin e tyre për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të këtij institucioni, të veçantë në rajon.

Ne nga ana e jonë kemi shprehur po ashtu gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetje, natyrisht përmes mekanizmave të vendit lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.
Me respekt!